

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE VLORE
NOTERE REZARTA KAPLLANI LUSHNJE
Nr Rep 1159
Nr Kol 492

DËSHMI TRASHËGIMIE

Sot më datë 01.Gusht 2018 , unë noteria publike Rezarta Kapllani anetarë e dhomës së noterëve Vlorë me zyrë noterie në adresën lagja' Çlirimi", Lushnje mora në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin që i përket:

KËRKUES: Xhejsika Kaja , me atësi Gëzim dhe amësi Vera e datëlindjes 03.10.1992 , lindur në Lushnje e banuese po aty , me gjendje civile -- begare , me shtetësi shqiptare, identifikuar me letërnjoftim ID dhe numer personal J26003113G madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimise ligjore për trashëgimlënësin Gëzim Hajdar Kaja.

BAZA LIGJORE: Nenet 360 e vijues të Kodit Civil Dispozitat e Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Për Noterine" i ndryshuar ,në menyre specifike nenet 53,5371 e vijues.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit në prani të kërkueses Xhejsika Kaja e cila kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të tij, unë noterja

VËRËJ

Se kërkuesja Xhejsika Kaja është vajza e të ndjerit Gëzim Kaja , ndaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka interes të ligjshëm në këtë shqyrtim, pra legitimohet të paraqesë kërkimin para kësaj zyre noterie

Gjithashtu zyra ime notierale në Lushnje në bazë të nenit 46/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit rezulton të ketë qenë në Lushnje

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, para noterit u shtruan për zgjidhje këto çështje:

1. përcaktimi i trashëgimtarëve të trashëgimlënëses të kërkuar nga kërkuesi
2. pjesët takuese të secilit prej tyre.

Për të zgjidhur këto probleme, unë noterja i referohem nenit 318 të Kodit Civil, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të secilit, bën të zbatueshëm ligjin e kohës se çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga shqyrtimi i fakteve rezulton e provuar se: më datë 04.07.2018 ka vdekur trashëgimlënësi Gëzim Kaja , fakt që vërtetohet nga certifikata e tij e vdekjes me nr serie 013613046 datë 13.07.2018 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 2 Lushnje .Në nenin 318 të Kodit Civil,

thuhet: "Trashëgimia çelet në kohën kur vdes trashëgimlénësi e në vendin ku ai ka patur banimin e tij të fundit. Ajo tregullohet sipas ligjës së kohës kur është celur". Në zbatim të dispozitës si më sipër trashëgimia për trashëgimlénësin Gëzim Kaja është celur që në ditën që ai ka vdekur. Për rregullimin e kësaj trashëgimie unë noterja do tu referohem dispozitave të Kodit Civil të vitit 1994 (që është në fuqi) I cili ka qenë në fuqi edhe ditën e vdekjes së trashëgimlénësit duke u shndërruar kështu në ligjin e kohës së çeljes së trashëgimisë" "meqënëse nga hetimi dhe konfirmimi elektronik nga dhoma kombëtare e noterise nuk rezulton që trashëgimlénësi të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, do të zbatohen rregullat e trashëgimisë me ligj, në zbatim të nenit 317 të K.Civil. Në nenin 361 i Kodit Civil aktual, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin: «Në radhë te parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta».

Në rastin që po shyrtohet trashëgimia ligjore e radhës së parë të trashëgimlénësit Gëzim Kaja bazuar në çertifikatat e administruara të përbërjes familjare nr serie 014280465 dt. 27.07. 2018 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Rrethit Lushnjë, sipas regjistrimit të popullsisë përvitet 1950/1974 në Loni Dhamo, Çertifikata nr serie 013613274 lëshuar dt 30.07.2018 nga Zyra e gjendjes civile 2 Lushnje sipas regjistrimit të popullsisë përvitet 1974 në Loni Dhamo Lushnje, çertifikata familjare me nr serie 014042521 lëshuar dt 30.07.2018 nga zyra e gjendjes Nr 2 Lushnje gjëndja familjare një ditë para vdekjes së trashgimlénësit, rezulton se i ndjeri ka qenë i martuar me shtetasen Vera Kaja e cila është bashkëshortja pasjetuese me atësi Avdyl dhe amësi Drita e dt 14.03.1973 dhe nga kjo lidhje u kane lindur dy fëmijë, përkatësisht shtetasit: 1- Xhejsika Kaja me atësi Gëzim dhe amësi Vera me dt 03.10.1992 banues në Lushnje 2 - Franko Kaja me atësi Gëzim dhe amësi Vera, i datelindjes 04.09.1998 lindur në Lushnje e banues po aty te cilët kanë qenë gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlénësit duke gëzuar kështu zotësi për të trashëguar atë konform nenit 320/1 te Kodit Civil

- Nga hetimi nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e mësipërm të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate, apo të jetë përashtuar nga trashëgimia e babait të tyre.
- Gjithashtu nuk rezulton që trashëgimlénësi të ketë pasur martesa të mëparshme, as të ketë pasur fëmijë të tjerë jashtë martese, apo të birësuar.
- Kërkuesja më deklaroj se nuk ka trashëgimtarë të tjerë ligjorë, përvëç atyre të pasqyruar në trungun familjarë dhe të pasqyruar në çertifikatat e lindjeve të depozituara prej saj. Për sa më lart, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlénësit Gëzim Kaja janë bashkëshortja pasjetuese Vera Kaja dhe dy fëmijët e tij Xhejsika Kaja, Franko Kaja të cilët e trashëgojnë babanë e tyre në 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e saj në të njëjtën masë.

Shpenzimet notoriale të përcaktuara nga urdhëri Nr. 306 date 31.07.2013, janë në ngarkim të kërkuesit dhe përbëhen nga ato për paraqitjen e kërkuesës dhe leshimin e trashëgimise ligjore.

PËR KËTO ARSYE

Unë notere Rezarta Kapllani në zbatim te Ligjit 7829 date 01.06.1994 "Për Noterinë"; ndryshuar Ligjin 131/2013 neni 53 e vijues i ketij Ligji,

VENDOSA

Pranimin e kërkueses Xhejsika Kaja.

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Gëzim Hajdar Kaja ,duke njojur si trashëgimtarë ligjore të rradhës së parë të tij :


- | | |
|------------------|-----------------|
| 1. Vera Kaja | - bashkëshortja |
| 2. Xhejsika Kaja | - e bija |
| 3. Franko Kaja | - i biri |

të cilët e trashëgojnë trashëgimlënësin në 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore secili, si dhe përgjigjen për detyrimet e tij trashëgimore në të njëjtën masë.

Kjo dëshmi trashëgimie u redaktua dhe u lëshua sot më datë 01.Gusht .2018 në Lushnje në 5(pese) kopje me të njëjtën vlerë përdorimi, nga të cilat nje kopje ruhet në arkivin e kësaj zyre ,të tjerat iu dhanë kërkueses.

NOTERE

REZARTA KAPLLANI



A handwritten signature "Rezarta Kapllani" is written over a circular blue ink stamp. The stamp contains the text "REZARTA KAPLLANI" around the perimeter and "LAWYER" in the center.



A handwritten signature "Rezarta Kapllani" is written over a circular blue ink stamp. The stamp contains the text "REZARTA KAPLLANI" around the perimeter and "LAWYER" in the center.